



## Periodik mujor Nr. 174 Nëntor 2023

**Në  
këtë  
periodik  
do të lexoni:**

**Mbi hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 76/2023  
“Për fondet e pensionit privat”**

**VËSHTRIM  
MBI TREGJET**

**Tregu i Sigurimeve, Janar - Tetor 2023**

4

**ZHVILLIME TË TJERA**

**BOTIME  
PROFESIONALE**

5 - 14

**INFORMACIONE  
NDËRKOMBËTARE**

15-17

## Mbi hyrjen në fuqi të Ligjit nr. 76/2023 “Për fondet e pensionit privat”

Ligji për “Për fondet e pensionit privat”, i miratuar nga Kuvendi i Shqipërisë, hyri në fuqi më 6 nëntor 2023. Ky ligj, përmirëson bazën ligjore të tregut të fondeve të pensioneve private, duke e përafuar atë me Direktivën 2016/2341/KE “Për veprimtarinë dhe mbikëqyrjen e Institucioneve të Pensionit Profesional”, IORP II. Hartimi i tij është pjesë e zbatimit të Planit Kombëtar për Integrimin Evropian për periudhën 2021-2024.

Mbrojtja e interesave të anëtarëve të fondit të pensionit privat, si edhe nxitja e pjesëmarrjes në skemën e pensionit privat, janë ndër synimet kryesore të këtij ligji.

Një nga risitë e këtij ligji është krijimi i formave të reja të fondeve të pensionit me qëllim nxitjen e pjesëmarrjes në këto fonde. Ligji, për herë të pare, njeh edhe formën e fondit të pensionit me pjesëmarrje të mbyllur. Fondi me pjesëmarrje të mbyllur mund të krijohet nga një punëdhënës, disa punëdhënës, ose një entitet i organizuar si bashkim punëdhënësish, sindikatë, bashkime sindikatash apo shoqatë, në cilësinë e sponsorit të cilët krijojnë një fond pensioni me pjesëmarrje të mbyllur. Krahas saj është edhe fondi me pjesëmarrje të hapur, i cili ka qenë edhe në ligjin e mëparshëm, që krijohet nga shoqëria administruese dhe nuk parashikon kufizime në anëtarësim.

Ndër risitë e tjera që sjell ligji është edhe vendosja e kërkesave më të larta për transparencë ndaj anëtarëve të fondeve të pensionit privat, përcaktimi i kërkesave shtesë për qeverisjen e shoqërisë administruese, parashikimi i lehtësive fiskale për anëtarët e fondeve të pensionit privat, si edhe ulja e komisionit vjetor të administrimit të aktiveve të fondit, i cili nuk duhet të kalojë në asnjë rast 2.5% në vit, të vlerës neto të aktiveve të fondit të pensionit privat.

Ligji i ri parashikon edhe rregullime që lidhen me marketingun dhe veprimtarinë promovuese të fondit të pensionit privat, duke i bërë këto fonde më shumë të njohura për individët dhe punëdhënësit që duan të kontribuojnë për punëmarrësit e tyre.

Ligji “Për fondet e pensionit privat”, ofron alternativa për krijimin e një portofoli investimi më të diversifikuar për anëtarin, duke bërë të mundur rritjen e kthimit nga investimi, si edhe lejon që për herë të parë, në politikat e investimit për fondet e pensionit privat të merren në konsideratë faktorët mjedisorë, shoqërorë dhe qeverisës të shoqërisë.

Ligji, gjithashtu, krijon kushte për ofrimin e shërbimeve ndërkufitare si një ndër kërkesat e Direktivës IORP II, kur Shqipëria të bëhet vend anëtar i Bashkimit Evropian.

---

Ligji gjendet i publikuar në faqen zyrtare të Autoritetit, në linkun e mëposhtëm:

<https://amf.gov.al/read/Law.asp?id=20410>

---

# VËSHTRIM MBI TREGJET

## Zhvillimet e Tregut të Sigurimeve në Shqipëri, Janar-Tetor 2023


Të ardhurat nga primet e shkruara bruto të sigurimit për muajin janar-tetor 2023 kapën vlerën 18,838 milionë lekë, ose 9.64% më shumë se në periudhën janar-tetor 2022. Gjatë periudhës janar-tetor 2023, numri i kontratave të sigurimit të lidhura arriti në 1,211,966 me një rritje prej 11.22% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Tregu mbetet i orientuar tek sigurimet e Jo-Jetës, të cilat sollën 91.94% të vëllimit të përgjithshëm të primeve, sigurimet e Jetës kanë 8.00% dhe risigurimi 0.065 %. Parë nga këndvështrimi i ndarjes së tregut sipas llojit të sigurimit, i detyrueshëm dhe vullnetar, primet e shkruara bruto të sigurimit vullnetar zënë 39.45% dhe primet e shkruara bruto të sigurimit të detyrueshëm zënë 60.55% të totalit të tregut.

Gjatë periudhës janar-tetor 2023, dëmet e paguara bruto në tregun e sigurimeve, arritën në rreth 5,738 milionë lekë, ose 7.77% më shumë se në periudhën janar-tetor 2022.

Dëmet e paguara bruto në sigurimin e motorik për periudhën janar-tetor 2023 kapën vlerën 3,970 milionë lekë, duke pësuar një rritje me rreth 8.35% krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

### Struktura e tregut të sigurimeve, Janar-Tetor 2023 (Në %)



Primet e sigurimit të detyrueshëm motorik, gjatë periudhës janar-tetor 2023 arritën rreth 11,407 milionë lekë, ose 7.25% më shumë se në periudhën janar-tetor 2022.

# ZHVILLIME TË TJERA

## Zhvillohët konferenca rajonale e vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore “E ardhmja e mbikëqyrjes dhe e tregut të sigurimeve”



Autoriteti Austriak i Tregut Financiar (FMA) organizoi në datat 27-28 nëntor në Vjenë, Austri, konferencën rajonale “E ardhmja e mbikëqyrjes dhe e tregut të sigurimeve”, ku morën pjesë përfaqësues nga Autoritetet rregullatore të tregut të sigurimeve dhe të Shoqatave të Siguruesve të vendeve të Evropës Qendrore, Lindore dhe Juglindore (CESEE).

Drejtorja Ekzekutive në detyrë e Autoritetit, Zj. Mimoza Kaçi, folëse në panelin “E ardhmja e sigurimeve në rajon - rreziqet dhe potencialet”, prezantoi zhvillimet e tregut të sigurimeve në Shqipëri dhe potencialet për rritje, si dhe sfidat e Autoritetit në drejtim të përafrimit të kuadrit ligjor dhe mbikëqyrës në sigurime me direktivat evropiane të fushës.

Në konferencë u diskutua mbi rreziqet makroekonomike dhe stabilitetin financiar, tendencat kryesore të tregut të sigurimeve në rajonin e Evropës Qendrore, Lindore dhe Transkaukazi, ndikimin e teknologjive moderne në mbrojtjen konsumatore, produktet e sigurimeve në kuadër të ndryshimeve klimatike, si dhe rëndësinë e rajonit për siguruesit austriakë.

Konferenca i shërbeu rritjes së bashkëpunimit ndërmjet autoriteteve mbikëqyrëse të vendeve të rajonit dhe adresimit të sfidave të përbashkëta, për forcimin e mbikëqyrjes dhe zhvillimit të tregut të sigurimeve.

## **Projekt i asistencës teknike për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare nga Departamenti Amerikan i Thesarit**


Në kuadër të projektit të asistencës teknike për Autoritetin e Mbikëqyrjes Financiare nga Departamenti Amerikan i Thesarit, ekspertët e projektit zhvilluan vizitën e tyre të parë në Autoritet. Ata zhvilluan një sërë takimesh me përfaqësues të Autoritetit, të institucioneve të pushtetit qendror dhe vendor, si dhe me grupe të tjera të interesit. Në këto takime, ekspertët e Zyrës së Asistencës Teknike (OTA) vlerësuan harmonizimin e kuadrit ligjor e rregullator të tregjeve nën mbikëqyrjen e AMF-së me direktivat e Bashkimit Evropian, si edhe me standardet dhe praktikën më të mira ndërkombëtare, si parakusht për zhvillimin e mëtejshëm të këtyre tregjeve.

Asistenca teknike fokusohet në dy drejtime kryesore: në fushën e sigurimeve dhe në atë të tregjeve të kapitalit. Në tregun e sigurimeve, asistenca synon forcimin e kapaciteteve mbikëqyrëse, përmirësimin e sistemeve të teknologjisë së informacionit, rritjen e standardeve për mbrojtjen ndaj rreziqeve kibernetike, si dhe ndërgjegjësimin e konsumatorëve për produktet dhe shërbimet financiare.

Në fushën e tregjeve të kapitalit, po vlerësohet mundësia për të ofruar mbështetje teknike me qëllim nxitjen e emetimit të instrumenteve të borxhit nga kompanitë me kapital shtetëror, apo njësitë e qeverisjes vendore, për të financuar projektet e tyre të zhvillimit. Ky është hapi i parë drejt një projekti ku Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare dhe Ministria e Financave dhe Ekonomisë do të bashkëpunojnë në zbatim të Dokumentit Politik “Për Krijimin e një Mjedisi Mundësues për Zhvillimin e Tregjeve të Kapitalit në Shqipëri, 2023-2027”, miratuar me Vendimin Nr. 266, datë 27.04.2023 të Këshillit të Ministrave, si edhe “Strategjisë së AMF-së 2023-2027”.

Asistenca teknike fokusohet në dy drejtime kryesore: në fushën e sigurimeve dhe në atë të tregjeve të kapitalit.

# AMF nxjerr për konsultim publik projektregulloren “Për formën dhe përmbajtjen e raportimit periodik pranë Autoritetit të shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucioneve të tregut”



Projektrregullorja publikohet në faqen zyrtare të Autoritetit, për konsultim publik, në linkun e mëposhtëm:  
<https://amf.gov.al/projekt.asp?id=95>

Faqe Kryesore ▶ Legjislacioni ▶ Projektakte ▶  
Projektregullore “Për formën dhe përmbajtjen e raportimit periodik pranë Autoritetit të shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbim tregut”

Projektregullore “Për formën dhe përmbajtjen e raportimit periodik pranë Autoritetit të shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucioneve të tregut”

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare, në zbatim të Ligjit nr. 62/2020, datë 14.05.2020 "Për Tregjet e Kapitalit", ka hartuar projektregulloren “Për formën dhe përmbajtjen e raportimit periodik pranë Autoritetit të shoqërive komisionere, bankave që ofrojnë shërbime investimi në tituj dhe institucioneve të tregut”.

## Mision i asistencës teknike nga ekspertët e TAIEX, për zhvillimin e kuadrit ligjor në tregun e sigurimeve



### AUTORITETI I MBIKËQYRJES FINANCIARE

Ekspertë të TAIEX-it (*Technical Assistance and Information Exchange*), pjesë e Agjencisë së Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare të Kroacisë (HANFA), zhvilluan në datat 13-17 nëntor, misionin e tyre në mbështetje të përafrimit të legjislacionit shqiptar në fushën e sigurimeve me direktivat e Bashkimit Evropian.

Gjatë këtij misioni u trajtuan çështje kryesore që lidhen me zbatimin e direktivës së regjimit mbikëqyrës Solvency II, u shpjeguan konceptet e reja të saj, me qëllim përshtatjen dhe integrimin e tyre në kuadrin ligjor të sigurimeve në vend. Ekspertët ndanë përvojat dhe praktikatat më të mira të vendeve të tjera, që e kanë kaluar më herët procesin e përafrimit të legjislacionit me këtë direktivë.

Asistenca teknike e kërkuar nga Autoriteti, u realizua në kuadër të zbatimit të objektivave kryesore të AMF-së, parashikuar në “Strategjinë e Autoritetit 2023-2027”, si edhe të angazhimit të Autoritetit në procesin e anëtarësimit të Shqipërisë në Bashkimin Evropian.



## AMF organizon workshop mbi zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar 17, për shoqëritë në tregun e sigurimeve



**Standardet**

**Ndërkombëtare**

**të Raportimit**

**Financiar**

**IFRS 17,**

**“Kontratat e Sigurimit”**

Autoriteti i Mbikëqyrjes Financiare organizoi më 20 nëntor një workshop mbi zbatimin e Standardit Ndërkombëtar të Raportimit Financiar, SNRF17, për shoqëritë e sigurimeve. Në gusht të këtij viti, Bordi i AMF-së miratoi Udhëzimin “Mbi Raportet e Shoqërive të sigurimit për zbatimin e SNRF 17 “Kontratat e Sigurimit”” i cili përcakton edhe format, afatet dhe përmbajtjen e raportimit të shoqërive të sigurimit, të cilat hartojnë dhe raportojnë pasqyrat financiare, në përputhje me SNRF.

Pjesë e standardeve të raportimit financiar është edhe zbatimi i SNRF 17 “Kontratat e sigurimit”, i cili zëvendëson SNRF 4, do të hyjë në zbatim duke nisur nga 1 janar 2025. Zbatimi i SNRF 17 parashikohet të ketë efekt të gjerë mbi paraqitjen e pasqyrave financiare, si dhe të sjellë një ndikim të drejtpërdrejtë në metodologjinë e llogaritjes së provigjoneve. Në zbatimin e SNRF 17 përfshihen edhe koncepte të reja, si marzhi i shërbimit kontraktor, rregullimi i rrezikut, etj.

Pjesëmarrës në këtë workshop ishin drejtuesit e financës dhe aktuarë të shoqërive të sigurimit të Jetës dhe Jo-Jetës që veprojnë në vend. Aktiviteti u zhvillua në kuadër të zbatimit të Strategjisë së AMF-së për edukimin financiar, në bashkëpunim me Shoqatën e Siguruesve të Shqipërisë dhe Shoqatën e Siguruesve të Jetës, Pensioneve dhe Fondeve të Investimeve.

Për të lexuar të plotë udhëzimin e miratuar nga AMF “Mbi raportimin e shoqërive të sigurimit për zbatimin e SNRF 17 Kontratat e sigurimit” klikoni në linkun më poshtë:

[https://amf.gov.al/pdf/ligje/UdhezimmbiraportimezbatimiteIFRS17,Nr146,dt31\\_08\\_2023\\_docx.pdf](https://amf.gov.al/pdf/ligje/UdhezimmbiraportimezbatimiteIFRS17,Nr146,dt31_08_2023_docx.pdf)

Udhëzimi i miratuar nga AMF “Mbi raportimin e shoqërive të sigurimit për zbatimin e SNRF 17 Kontratat e sigurimit” gjendet në linkun:

[https://amf.gov.al/pdf/ligje/UdhezimmbiraportimezbatimiteIFRS17,Nr146,dt31\\_08\\_2023\\_docx.pdf](https://amf.gov.al/pdf/ligje/UdhezimmbiraportimezbatimiteIFRS17,Nr146,dt31_08_2023_docx.pdf)

## AMF takim me përfaqësues të lartë të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për asistencë teknike në fushën e tregjeve të kapitalit



Drejtorja Ekzekutive në detyrë e Autoritetit të Mbikëqyrjes Financiare, Zj. Mimoza Kaçi zhvilloi më datë 22 nëntor një takim pune me ekipin e departamentit për zhvillimin e tregjeve financiare dhe të kapitalit pranë Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim (BERZH), z. Alex Pivovarsky. Ai u shoqërua nga Zj. Ekaterina Solovova, përfaqësuese e zyrës së BERZH në Shqipëri. Në takim u diskutua mbi prioritetet e Autoritetit dhe mundësitë e bashkëpunimit me BERZH, përmes mbështetjes teknike për zhvillimin të tregjeve të kapitalit në vend.

Zj. Kaçi pasqyroi zhvillimet në tregjet e kapitalit, plotësimin e kuadrit ligjor e rregullator dhe harmonizimin e tij me direktivat e Bashkimit Evropian. Ajo vlerësoi gatishmërinë e BERZH për ofrimin e ekspertizës në mbështetje të zhvillimit të tregjeve të kapitalit, me synim rritjen e pjesëmarrjes së emetuesve në tregjet e kapitalit, zgjerimin e gamës së produkteve financiare dhe diversifikimin e bazës së investitorit. Mbështetja teknike përkon me objektivat e AMF-së në zbatim të dokumentit politik për zhvillimin e tregjeve të kapitalit, hartuar në bashkëpunim me Ministrinë e Financave dhe Ekonomisë. Ajo do t'i shërbejë zbatimit të prioritetëve të AMF-së, parashikuar në "Strategjinë e Autoritetit 2023-2027", si edhe angazhimeve të marra nga Shqipëria në kuadër të negociatave për kapitullit 9 "Shërbimet Financiare", që kryesohet nga AMF.

---

Në takim u diskutua mbi prioritetet e Autoritetit dhe mundësitë e bashkëpunimit me BERZH, përmes mbështetjes teknike për zhvillimin të tregjeve të kapitalit në vend.

---

## **OECD publikon “Economic Outlook”**



*Sekretari i Përgjithshëm i OECD-së Mathias Cormann dhe ekonomistja kryesore Clare Lombardelli prezantuan më 29 nëntor 2023 në një konferencë për shtyp të OECD-së Raportin “Vështrimi ekonomik”, duke dhënë perspektivën ekonomike në vijim.*

Ekonomia globale vazhdon të përballet me sfidat e inflacionit dhe perspektivat e ulëta të rritjes. Deri më tani në 2023, rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto ka qenë më e fortë se sa pritej, por tani po zbehet për shkak të kushteve më të shtrënguara financiare, rritjes së dobët të tregtisë dhe besimit më të ulët të biznesit dhe konsumatorëve. Rreziqet për perspektivën afatshkurtër tregojnë një anim në rënie dhe përfshijnë tensionet e rritura gjeopolitike, për shembull për shkak të konfliktit në zhvillim pas sulmeve terroriste të Hamasit ndaj Izraelit; dhe një ndikim, më të madh se sa pritej, nga shtrëngimi i politikës monetare. Nga ana pozitive, rritja mund të jetë gjithashtu më e fortë nëse familjet shpenzojnë më shumë nga kursimet e tepërta të grumbulluara gjatë pandemisë. Katër janë pikat kryesore të trajtuara në raport:

### **Rritja globale do të mbetet e moderuar**

Rritja globale parashikohet të jetë 2.9% në 2023 dhe të dobësohet në 2.7% në 2024. Ndërsa inflacioni zvogëlohet më tej dhe të ardhurat reale forcohen, ekonomia botërore parashikohet të rritet me 3% në 2025. Rritja globale mbetet shumë e varur nga rritja e shpejtë e ekonomive aziatike.

### **Inflacioni pritet të zbutet**

Inflacioni total pritet të përputhet me objektivat e bankave qendrore në shumicën e ekonomive kryesore, deri në fund të vitit 2025, kjo në kushtet kur nuk do të ketë goditje të mëtejshme të mëdha ndaj çmimeve të ushqimeve dhe energjisë. Inflacioni total vjetor i OECD-së pritet të bjerë gradualisht në 5.2% dhe 3.8% respektivisht, në 2024 dhe 2025 nga 7.0% që ishte në vitin 2023.

Vijon ...

Materiali i publikuar  
gjendet në linkun:  
<https://www.oecd.org/economic-outlook/november-2023/>



... vijon

### **Politika fiskale duhet të parandalojë rritjen e paqëndrueshme të borxhit**

Raportet e borxhit publik ndaj PBB-së sot qëndrojnë në nivele të larta, duke i krahasuar edhe nga një perspektivë historike. Qeveritë përballen me presione fiskale në rritje, që rrjedhin nga burime të shumta, duke përfshirë shoqërinë në plakje dhe nevojën për të trajtuar ndryshimet klimatike. Parashikimet tregojnë se në mungesë të veprimeve të qeverisë, niveli i borxhit publik ndaj PBB-së pritet të vazhdojë të rritet në nivele të larta.

### **Rritja e tregtisë është e dobët**

Rritja e tregtisë globale ka qenë çuditërisht e dobët gjatë këtij viti. Kjo është shqetësuese duke pasur parasysh rëndësinë e tregtisë për produktivitetin dhe zhvillimin. Vëllimet e tregtisë së mallrave ranë me 1.5% në gjysmën e parë të vitit 2023, ndërsa vëllimi i tregtisë së shërbimeve vlerësohet të jenë rritur me 6.4%, pasi normalizimi i vazhdueshëm i udhëtimeve në Azi ndihmoi në nxitjen e turizmit. Tregtia e dobët nuk është një zhvillim krejtësisht i ri. Që pas daljes nga pandemia, tregtia ka rënë në raport me PBB, veçanërisht tregtia e mallrave.

Materiali i publikuar gjendet në linkun:

<https://www.oecd-ilibrary.org/sites/7a5f73ce-en/1/3/1/index.html?itemId=/content/publication/7a5f73ce-en&csp=ff1338015957b6cc89df6710d74ff9f1&itemIGO=oecd&itemContentType=book>

## RIKTHIMI I RITJES

*Editorial nga Clare Lombardelli, OECD Chief Economist*

Inflacioni po zbutet, por rritja po ngadalësohet. Shtrëngimet e nevojshme të politikave monetare për të trajtuar inflacionin po japin efekt. Pavarësisht se rritja e Prodhimit të Brendshëm Bruto është më të fortë se sa pritej në vitin 2023, shtrëngimi i kushteve financiare, tregtia e dobët dhe besimi i munguar po dëmtojnë. Tregjet e banesave dhe ekonomitë e varura nga bankat, veçanërisht në Evropë, po e ndjejnë ndikimin.

Ritmi i rritjes është i pabarabartë. Tregjet në zhvillim në përgjithësi po ecin më mirë se ekonomitë e përparuara. Rritja e Evropës mbetet pas Amerikës së Veriut dhe ekonomive të mëdha aziatike. Inflacioni, ndonëse zbutet, mbetet një shqetësim.

Ne po projektojmë një ulje të butë për ekonomitë e përparuara, por kjo nuk është aspak e garantuar. Marrëdhënia midis inflacionit, aktivitetit dhe tregjeve të punës ka ndryshuar, duke e bërë të vështirë të gjykohet ndikimi i plotë i shtrëngimit të politikës monetare. Në Shtetet e Bashkuara, ekonomia po demonstroi më shumë forcë sesa pritej dhe ekziston rreziku që inflacioni të provojë të jetë i vazhdueshëm. Në eurozonë, ndikimi i plotë i politikës monetare më të shtrënguar ende nuk është shfaqur dhe aktiviteti mund të goditet më fuqishëm nga sa presim.

Shumë tregje në zhvillim kanë treguar elasticitet të konsiderueshëm gjatë vitit të kaluar, por vendet e karakterizuara nga dobësi strukturore të borxhit janë vënë nën shqyrtimin e tregut.

Vijon ...

Materiali i publikuar  
gjendet në linkun:

<https://oecdecoscope.blog/2023/11/29/restoring-growth/>

## RIKTHIMI I RITJES

*Editorial nga Clare Lombardelli, OECD Chief Economist*

... Vijon

Tregtia globale është e dobët. Jo vetëm faktorët ciklikë, por edhe strukturorë po shkaktojnë një ngadalësim të shkallës me të cilën zinxhirët e vlerës po integrohen në të gjithë vendet. Mundësitë për rritje, veçanërisht nga tregtia më e madhe e shërbimeve, po mungojnë. Ne duhet të ringjallim tregtinë globale. Qëndrueshmëria në zinxhirët e vlerave globale ofrohet më së miri nga diversifikimi, jo nga proteksionizmi dhe politikat e brendshme.

Në shumë vende, presionet fiskale janë në rritje. Ndryshimet demografike, dekarbonizimi dhe një kombinim i pagesave në rritje të interesit dhe rritjes së ngadalë bënë që vendet të përballen me një perspektivë fiskale sfiduese. Qeveritë duhet të ndërmarrin veprime të guximshme për të reduktuar presione të tilla dhe për t'i dhënë një fokus më të madh rritjes në politikëbërjen e tyre. Kjo nënkupton reformimin e politikave të tregut të punës dhe pensioneve, rritjen e konkurrencës dhe përdorimin e levave fiskale për të rritur kapitalin njerëzor dhe rritjen e produktivitetit, duke përfshirë investimet e nevojshme për të ofruar tranzicionin e gjelbër.

Si përmbledhje, ekonomia globale po përballet me inflacionin, ngadalësimin e rritjes dhe presionet fiskale në rritje. Politikëbërësit duhet të kenë prioritet stabilitetin makroekonomik, reformat strukturore, politikat e zgjuara fiskale dhe bashkëpunimin ndërkombëtar, për të nxitur një rritje të qëndrueshme dhe gjithëpërfshirëse.

Materiali i publikuar  
gjendet në linkun:

<https://oecdecoscope.blog/2023/11/29/restoring-growth/>

## BOSNJE-HERCEGOVINA

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave të publikuar nga Agjencia e Sigurimeve të Bosnjës dhe Hercegovinës, AZOBiH, tregu i sigurimeve të Bosnjë dhe Hercegovinës në fund të tremujorit të tretë 2023 realizoi një vëllim të primeve të shkruara bruto me vlerë 744.2 milionë BAM ose rreth 380.5 milionë euro, me një rritje të ndjeshme krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.

Segmenti i sigurimit të Jo-Jetës realizoi rreth 80.2% të vëllimit total të tregut, me një rritje prej 12.9% më shumë se e njëjta periudhë e një viti më parë. Segmenti tjetër i sigurimit të Jetës realizoi pjesën tjetër prej 19.8 % me një rritje 5.3% krahasuar me të njëjtë periudhë të një viti më parë.

Totali i dëmeve të paguara në nivel tregu arriti në 302.3 milionë BAM, ose rreth 154.5 milionë euro. Kjo shpreh një rritje prej 6.7% në terma vjetorë. Dëmet në sigurimin e Jetës zinin 77.2 milionë BAM, ndërsa dëmet për nënklasat e Jo-Jetës, u raportuan pagesa me vlerë 225.1 milionë BAM.

Siguruesit e FBiH-së gjeneruan pothuajse 70% të vëllim total të primeve të shkruara bruto, me vlerë 517.8 milionë BAM, ndërsa siguruesit e Republikës Serbe të Bosnjës realizuan prime të shkruara bruto me vlerë 226.4 milion BAM.

## KROACI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas raportit të publikuar nga Agjencia Kroate e Mbikëqyrjes së Shërbimeve Financiare, HANFA, në fund të shtatorit 2023 vëllimi i primeve të shkruara bruto i mbledhur nga 15 siguruesit vendas arriti në 1.3 miliardë euro. Sigurimet e Jetës zinin 17.15% ose rreth 0.2 miliardë euro, ndërsa vëllimi i primeve të shkruara bruto për sigurimin e Jo-Jetës ishte 1.1 miliardë euro, rreth 82.85% e vëllimit total të primeve.

Struktura e primeve të arkëtuara në sigurimin e Jo-Jetës dominohet nga sigurimi i përgjegjësishë për mjete motorike 35.7%, i ndjekur nga sigurimi i mjeteve tokësore 17.9% dhe sigurimi nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore prej 9.3%.

Shuma e dëmeve të paguara, në tetë muajt e parë të vitit 2023, arriti në 813.4 milionë euro. Nga kjo shumë 315.4 milionë euro janë të lidhura me sigurimet e Jetës, prej 38.8%, ndërsa 498 milionë euro janë të lidhura me kontratat e sigurimit të Jo-Jetës, prej 61.2%.

Brenda totalit të dëmeve të shlyera në sigurimet Jo-Jetë, shumat më të mëdha kanë të bëjnë me sigurimin e përgjegjësishë nga automjetet, 40.7%, sigurimin e automjeteve tokësore, 20.9% dhe sigurimin nga zjarri dhe fatkeqësitë natyrore, 8.9%.

## **KOSOVA**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas raportimeve nga Banka Qendrore e Kosovës, BQK, 12 shoqëritë aktive të sigurimeve në vend, në tremujorin e tretë 2023, realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto në vlerë prej 110.1 milionë euro, me rritje të konsiderueshme krahasuar me fundin e shtatorit 2022.

Sipas publikimit mujor “Sistemi Financiar” në faqen online të BQK-së, vëllimi i primeve të shkruara bruto të sigurimit të Jetës arritën në 5.1 milionë euro. Në të njëjtën kohë, vëllimi i primeve të shkruara bruto në sigurimin e Jo-Jetës u rrit me 12.5% në terma vjetorë, duke arritur në 105 milionë euro, nga të cilat 54.3 milionë euro për MTPL-në e brendshme, 7.0 milionë euro për policat kufitare dhe 43.7 milionë euro për klasa të tjera vullnetare.

Sipas shifrave mujore të BQK, fitimi i përgjithshëm neto i tremujorit të tretë 2023 për siguruesit kosovarë arriti në 9.4 milionë euro, pothuajse i trefishuar nga 3.1 milionë euro krahasuar me një vit më parë. Asetet në zotërim nga kompanitë kosovare të sigurimeve u rritën duke arritur në 300.7 milionë euro në fund të shtatorit 2023, nga 259 milionë euro në fund të shtatorit 2022.

## **MALI I ZI**

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas të dhënave tremujore të tregut të sigurimeve, të publikuara nga Agjencia e Mbikëqyrjes së Sigurimeve në Malin e Zi, në fund të shtatorit 2023, tregu i sigurimeve arriti në 90.98 milionë euro, ose rreth 9.90% më shumë krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë. Vlera e dëmeve të paguara nga siguruesit arriti në 34.68 milionë euro, me një rritje 4.76% më shumë në terma vjetore.

Segmenti i sigurimit të Jetës realizoi rreth 17.41% të totalit të tregut të sigurimeve ose 15.84 milionë euro, me një rritje prej 4.42% e shprehur në terma vjetorë. Ndërsa segmenti i sigurimeve të Jo-Jetës arriti në 75.15 milionë euro, me rritje krahasuar me të njëjtën periudhë të një viti më parë.



## TURQI

[www.xprimm.com](http://www.xprimm.com)

Sipas shifrave të tremujorit, të publikuara Shoqata e Sigurimeve të Turqisë, në fund të shtatorit 2023 tregu lokal i sigurimeve u rrit me 123.41% në terma vjetore, duke arritur në 328.2 miliardë TRY, ose rreth 11.3 miliardë euro. Kjo rritje e tregut, e shprehur në monedhën evropiane, për shkak të diferencave të kursit të këmbimit midis 30 shtatorit 2023 dhe 30 shtatorit 2022, ishte +39.6% krahasuar me të njëjtën periudhë të në viti më parë.

Vëllimi i primeve të shkruara bruto në sektorin e sigurimit të Jetës u rrit me 92% në terma vjetore, duke arritur në 39.5 miliardë TRY, ndërsa sigurimet e Jo-Jetës realizuan një vëllim të primeve të shkruara bruto me rritje më shumë se +128.5% krahasuar me një vit më parë, duke arritur në 288.6 miliardë TRY.

Shoqata e Sigurimeve të Turqisë ka 69 anëtarë aktivë.



Për informacion të mëtejshëm  
na kontaktoni:

Rr. "Dora D'Istria", Nr. 10 , P.O.Box 8363, Tiranë  
Tel: +355 42 251 355/6 | Fax: +355 42 250 686  
[amf@amf.gov.al](mailto:amf@amf.gov.al) | [www.amf.gov.al](http://www.amf.gov.al)